



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË

Nr. 2230 /1prot.

Tepelenë, më 08.07. 2026

Njoftim për konsultim publik

Titulli i Projekt-aktit : “Plani i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Tepelenë”

Propozuesi : Gramos Sako , Kryetari i Bashkisë.

Sqarime për projekt-aktin : Qëllimi i PVMIM konsiston në sfidën e re që ka bashkia për të ofruar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e saj, duke harmonizuar interesat e të gjithë aktorëve për një menaxhim të qëndrueshëm, duke optimizuar koston e shërbimit kundrejt buxheteve të limituara që ka bashkia, ku do të krahasohen dhe vlerësohen të gjitha opsionet e mundshme si dhe në hartimin e nevojave për investime kapitale për sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu plani fokusohet edhe në përcaktimin e metodologjisë për zbatimin e sistemit të monitorimit, si dhe në ngritjen e kapaciteteve brenda bashkisë për zbatimin e planit.

Më konkretisht, ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- Përputhshmëri me Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve
- Opsionet e menaxhimit të mbetjeve: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare. Planit identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjësimin) final të mbetjeve
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementëve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbetjet në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e menaxhimit të mbetjeve
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbetjet sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

Kalendari i konsultimit : *Konsultimi publik do të realizohet në përputhje me Kalendarin e Konsultimit Publik*

Pjesëmarrës :

- **Nga ana e Bashkisë :** Anëtarë të Komisionit të Shërbimeve Publike dhe Sociale, të Komisionit të Planifikimit, Mbrojtjes së Territorit dhe Mjedisit, të Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Ligjeve, Kryetari i Këshillit Bashkiak, Sekretari i Këshillit Bashkiak, Anëtarët e Këshillit Bashkiak, Administrata e Drejtorisë së Planifikimit Urban të Bashkisë, N/kryetari i Bashkisë që mbulon Shërbimet Publike, Drejtori i Shërbimeve Publike

- **Nga komuniteti :** Banorë dhe administratorët e Njësive Administrative, *përfaqësues të biznesit dhe Shoqatave të Biznesit , OJF etj*

Format e konsultimit : *Takime publike*

Qëllimi i këshillimit publik	<i>Dialogu ndërmjet qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur dhe përfshirja e tyre në qeverisjen vendore është thelbësore për demokracinë vendore, sepse ajo forcon legjitimitetin e institucioneve demokratike vendore dhe efektivitetin e veprimeve të tyre. Procesi i konsultimit publik përbën shtyllën kryesore të një qeverie transparente, duke i'u mundësuar qytetarëve dhe grupeve të interesit diskutimin, dialogimin, monitorimin dhe vlerësimin e punës së pushtetit vendor. Këshillimi publik synon tërheqjen e mendimit të qytetarëve në lidhje me këtë projekt-akt, i cili prek të gjithë anëtarët e komunitetit të Bashkisë Tepelenë, familjet, bizneset, institucionet shtetërore, të cilët janë të interesuar për një mjedis sa më të pastër. Plani i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve është instrumenti kryesorë i planifikimit për përcaktimin e vizionit dhe objektivat specifike, të mundshëm nga ana ekonomike dhe mjedisore, në lidhje me drejtimit që do të ndërmarrë bashkia në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Këto objektiva specifike duhet të reflektojnë orietimet e politikës kombëtare drejt menaxhimit të integruar të mbetjeve, të aktualizuara në gjendjen ekzistuese të bashkisë. Mbi bazën e objektivave specifike të dakordësuar në të gjitha nivelet vendimarrëse dhe me grupet e interesit, plani fillon dhe analizon skenarët e mundshëm të organizimit të shërbimit të shoqëruar me koston përkatëse dhe politikën fiskale që duhet të ndjekë bashkia në mbulimin e plotë të koston. Ai përfundon me një plan veprimi konkret të ndarë në afate kohore, brenda një 5 vjeçari, sipas përgjegjësisve përkatëse të aktorëve të përfshirë në zbatimin e planit. Plani është një dokument planifikimi, i cili merr fuqi të plotë me miratimin nga Këshilli Bashiak. Këshilli i Bashkisë, si përfaqësues i komunitetit, kërkon të marrë më shumë informacion për ndikimin dhe efektet që ky vendim mund të ketë në komunitetin e Bashkisë, nëse ky projekt-vendim i shërben përmirësimit të jetës së komunitetit, nëse ai i shërben interesit publik si dhe nëse ai duhet miratuar siç është paraqitur, apo duhet të miratohet i përmirësuar.</i>
-------------------------------------	---

Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-akti	<i>Plani i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Tepelenë.</i> <i>Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qëndrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. PVMIM është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.</i> <i>Viti 1994 shënoi momentin kur autoritetet lokale ju deleguan shërbimet e menaxhimit të mbetjeve dhe shërbime të tjera pastrimi, duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për menaxhimin e tyre dhe njëkohësisht, duke u siguruar financimin nga qeverisja qendrore me anë të “granteve të pakushtëzuara”. Hartimi i Planit Vendor nga Njësitë e Vet-qeverisjes vendore është një detyrim ligjor i përcaktuar nga Ligji i ri nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i amenduar, ku në Nenin 12, pika 2 citohet: “Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisht të qeverisjes vendore harton Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e Nenit 10 të këtij ligji”.</i>
Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	1. Si e gjykoni situatën apo gjendjen e pastrimit në territorin e bashkisë tuaj 2. A jeni të kënaqur nga puna që kryen bashkia për një territor sa më të pastër, nëse jo si mendoni se mund të përmirësohet? 3. Cili është shqetësimi juaj më i madh për mbledhjen e plehrave? 4. Sa shpesh dëshironi që mblidhen mbeturinat tuaja ? 5. A jeni të gatshëm që të paguani për një shërbim më të mirë? 6. Si e merrni informacionin tuaj për grumbullimin e plehrave?

Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	<i>Komentet dhe rekomandimet tuaja mund të jepen direkt nëpërmjet pjesmarrjes Tuaj në takimet publike, por në pamundësi për të marrë pjesë në këto konsultime, ato mund të dërgohen me email, ose të dërgohen me postë BRENDË DATËS 27.07.2026</i> <i>:Keshilli.Bashkiak@tepelena.gov.al ose info@tepelena.gov.al, ose nëpërmjet postës në adresën: Bashkia Tepelenë, Sheshi “Lord Bajron”, Kodi postar 6301</i>
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me çështjen që konsultohet	<i>https://tepelena.gov.al/planet-vendore-draftet/</i>

Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerren Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit

Konsultimi publik do të realizohet sipas Kalendarit të Konsultimeve Publike. Pas realizimit të konsultimeve publike me komunitetin dhe grupet e interesit, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon :

1. *Mbajtja e procesverbalit të çdo takimi publik dhe bërja publike e tyre.*
2. *Marrja e Rekomandimeve me postë dhe bërja e tyre publike.*
3. *Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve, që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje.*
4. *Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit Komisionit të Shërbimeve Publike dhe Sociale dhe Komisionit të Ekonomisë dhe Financës*
5. *Shqyrtimi nga ana e komisioneve (mbledhjet e komisioneve janë të hapura për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar) të çdo rekomandimi dhe diskutimi i tij në komisione për të dalë me një vendim se*

cilat propozime mund të merren në konsideratë dhe cilat nuk mund të merren dhe për çfarë arsye.

6. *Hartimi i projekt-vendimit të përmirësuar bazuar në rekomandimet e konsultimit publik.*
7. *Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit.*
8. *Informimi i personave që kanë dhënë rekomandime për aktin, për marrjen në konsideratë të rekomandimit ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tij.*
9. *Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit*
10. *Njoftimi i administratës për aktin e miratuar*
11. *Monitorimi i zbatimit të tij*

Data e publikimit	08 Korrik 2026
-------------------	----------------

**KALENDARI I ZHVILLIMIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE ME QYTETARËT E
BASHKISË TEPELENË**

NR	NJËSIA ADMINISTRATIVE	DATA	ORA	VENDI
1	Kurvelesh	28.07.2026	10:00	Qendra e fshatit Progonat
2	Lopës	29.07.2026	10:00	Qendra e fshatit Sinanaj
3	Qendër – Qytet Tepelenë	30.07.2026	10:00	Pallati Kulturës Tepelenë

KRYETARI I BASHKISË
Gramos Sako

